

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, departamenti I eprgjitshem-divizioni civil, gjyqtari Enes Mehmeti dhe procesmbajtësja minire Krasniqi, ne ceshtjen juridiko-kontestimore te inicuar me padine e paditëses [REDACTED] me seli ne Prishtine, rr" [REDACTED]", kunder te paditurit [REDACTED] i nga Ferizaj rr" [REDACTED], per rimbursim demi, jashte seance me date 31.08.2015, merr ket:

## AKTGJYKIM

### -PER SHKAK TE PADEGJUESHMERISE/MOSBINDJES-

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses [REDACTED] me seli ne Prishtine, si e bazuar.

**DETYROHET** I padituri [REDACTED] nga Ferizaj rr" [REDACTED] që paditëses t'ia kompensojë shumën prej 246.00€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 22.03.2011 në Ferizaj, së bashku me kamatën e cila do të llogaritet sipas lartesisë që aplikojnë banakr për deponimet e reandomta të qytetareve për periudhe njëvjeçare, padestnim të caktuar, nga dita e ushtrimit të padisë, dates 28.04.2015 e deri ne pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedures në shumë prej 30.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

**OBLIGOHET** paditësja që të paguan taksën gjyqësore për padi dhe aktgjykim, në shumë prej 30.00€, mënjherë pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimi e përmbarrimit me forcë.

### Arsyetimi

Paditësja, në këtë gjyaktë ka ushtruar padi kundër të paditurit, për rimbursimin e dëmeve të kompenzuara, për shkak të veprimeve të kundërligjshem të të paditurit, që ka ndërmarr me rastin e shkaktimit të aksidentit në komunikacionin rrugor.

Gjykatës i kanë bashkangjitur provat dhe dëshmitë tjera material për ndodhin në aksident dhe për kompensimin e dëmeve, që paditësja ka përmbushur ndaj të tretëve, për shkak të veprimeve deliktore të të paditurit, në komunikacionin rrugor.

Gjykata, të paditurit, me datë 19.08.2015, i ka dorezuar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por i padituri Brenda afatit të përcaktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes ka gjetur se themelësia e kërkesëpadiës del nga faktete e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si duke patur parasysh faktin se I padituri ka



pranuar me rregull padine me prova dhe aktvendimin per pergjigje ne padi, gjykata bazuar ne nenin 150.6 te LPk-së ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 te LPk-së, që përjashton mundësin për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamaten ka vendosur ne bazë të nenit 277 te LMD-se, duke qenë se për paditësen lartësia e dëmit dhe shkaktesuesi i saj, kanë qenë të përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve te procedures kontestimore ne baze te nenit 452.1 te LPK-se, ndërsa paditësen në bazë të UA nr.2008/2 te KGJK-se, epr unifikimine taksave gjyqesore.

### GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.257/15 date 31.08.2015

Gjyqtari,  
Enes Mehmeti



Keshilla juridike: Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh ne gjykaten e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate. Afati fillon nga dita e neserme e pranimit te ketij aktgjykimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVO

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD,  
FERIZAJ I UROŠEVAC.

10 20 15

